



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

PROCEVERBAL I MBLEDHJES 26.11.2025

- I mbajtur sot më datë 26.11.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 14vota pro.
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu (Këshilltarët e pranishëm).
- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 28.10.2025 me të gjitha votat e të pranishmëve 14 vota pro.
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu (Këshilltarët e pranishëm).
- **Miratohet fillimi I mbledhjes me ketë rend dite si më poshtë vijon:**
 1. Miratimi i rendit të ditës.
 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.10.2025.
 3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha tetor 2025”.
 4. **P/Vendim** “ Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”.
 5. **P/Vendim** “ Për rritje e pakësim plani buxhetor të vitit 2025 të të ardhurave vendore”.
 6. **P/Vendim** “ Për linjat kryesore dhe oraret e transportit rrethqytetas”
 7. **P/Vendim** “ Për miratimin e ndërhyrjeve në pronë publike për efekt të mbrojtjes së pronave private”.
 8. **Të ndryshme:**
 1. **P/Vendim** “ Për emërtimin e prishjes së nënobjektit “Palestra e shkollës 9-vjeçare Vilson Blloshmi” Librazhd.
 2. **P/Vendim** “ Shtesë fondi për klubin e futbollit Sopoti”.
 3. Prezantimi dhe Diskutimi i Raportit të Performancës të Bashkisë Librazhd, viti 2024.

Kërkesë:

Dorheqja e Kryetarit të fshatit Librazhd Katund Z.Urim Mana.

Fillimi i mbledhjes:

1.P/Vendim “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha tetor 2025”.

Këshilltarja ,Arjana Çekrezi e merr fjalën;

Ky p/vendim tani dihet tashmë për çfarë bëhet fjalë,ne jemi njohur me materialet dhe une peronalisht jamë pro.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Sa konkretë janë si zyrë ? Si funksionon verifikimi i familjeve në terren? Dhe sot familjen nga Gizaveshi nuk e shikoj në listë fituese.Dhe ndihmat që shpërndani ,çfarë procedure ndiqni?Bashkia me çfarë e ndihmoj konkretisht familjen Buzra nga Gizaveshi?Çfarë kriteri duhet të plotësohet që të përfitohet ndihma ekonomike?

Përgjegjësi i Ndhmës Ekonomike z.Rexhep Shaka e merr fjalën;

Sa për rastin e familjes nga Gizaveshi,kjo familje trajtohet me ndihmë ekonomike,ne familjen Buzra e kemi ndihmuar dhe vazhdojmë ta ndihmojmë,e kemi ndihmuar me rregullimin e ambientit të mbrendshëm dhe të jashtëm,me ndihma ushqimore,me mobilje etj.

Këshilltarja ,Xhuljeta Boriçi e merr fjalën;

Si i përzgjidhni familjet përfituese për ndihmën ekonomik? Pasi kam një rast që një familje I hiqet ndihma ekonomike dhe familjes tjetër jo,ku te dyja familjet janë njësoj,si i bëni verifikimet në terren?Mos hiqni familje që vërtetë janë në nevojë.Ne si këshilltar duhet të kemi një listë për të gjitha familjet që janë realisht te varfëra dhe ju si zyrë duhet të keni informacion për këto familje.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Dokumentacioni duhet të jetë i plotë dhe Drejtoria përkatëse duhet të jetë e përgatitur dhe për pyetje jashtë p/vendimit.Të kemi çdo mbledhje këshili një relacion sqarues me më shumë detaje për çdo familje në nevojë.

Përgjegjësi i Ndhmës Ekonomike z.Rexhep Shaka e merr fjalën;

Problemi i Ndhmës Ekonomike është vërtetë shumë situatë e vështirë,sa për familjen që na përmendi këshilltarja, ne do ti qëndrojmë afër kësaj familje dhe do ta trajtojmë njësoj siç cdo familje tjetër.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha (Këshilltarët e pranishëm).

2. P/Vendim “ Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Duke lexuar relacionin e p/vendimit duket sikur fituesi është zgjedhur kush do e marri në përdorim këtë truall. Kush është subjekti që e kërkon këtë truall? Çfarë studimi është bërë? Çfarë lloji është trualli që po kërkohet? Nuk e di që si ky këshill bashkiak duhet të votoj këtë p/vendim, ku informacioni që ne kemi para nuk është i plotë. Kush mbanë përgjegjësi për këtë p/vendim dhe pse nuk është Drejtori në mbledhje të mbrojtë p/vendimin?

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

A dëmtohet zona? Çfarë interesi ekonomik ka bashkia ?

Unë jam e mendimit që ky p/vendimet të plotësohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta lëmë për mbledhjen tjetër.

Këshilltarja, Xhuljeta Boriçi e merr fjalën;

Dhe unë të njëjtin mendim kam që ky p/vendim të kalohet në mbledhjen e rradhës.

Këshilltari Veli Terziu e merr fjalën.

A janë mbledhur komisionet dhe si është votuar për këtë p/vendim?

Hidhet në votim sipas propozimeve që ky P/vendim të kalohet në mbledhjen e rradhës; Nuk miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota kundër.

Shënim:(P/Vendimi duhet plotësuar me dokumenta shtesë në momentin që do të kalohet për miratim. Kërkesë me shkrim nga kryeplaku i zones dhe nga Administratori që banorët ja në pro këtij p/vendimi dhe firmat e banorëve, të jetë i plotësuar me hartë dhe kartelë të saktë.)

3. P/Vendim “ Për rritje e pakësim plani buxhetor të vitit 2025 të të ardhurave vendore”.

drusor nga subjektet. Për vitin 2025 të ardhurat janë planifikuar në vlerën 220,385 mije leke.

Këshilltari Zenel Bahiti e merr fjalën.

Të gjithë ne e dime se bashkia mbahet me taksa dhe tarifa. Shikoj që keni ndryshuar nja tre zëra. Sponsorizimet janë me vlerën 0, taksa mbi tatimin e të ardhurave personale ka

ndryshuar,taksa e regjistrimit të automjeteve dhe pakësim të planit në sektorin e pyjeve.Kishte dhe një ndryshim tjetër që spo e kuptoja dhe thash të na I sqaroni me zëra.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Mos ka ndonjë gabim planifikim zëri tek të ardhurat personale si fillim është miratuar 120 milion dhe mbropa është shtuar me 30 milion,mos ka ndonjë lapsus nga ana juaj?

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Meqënëse tha dhe Zeneli që bashkia mbahet me taksa dhe tarifa.Çfarë praktike ndjek kjo Drejtori në qoftë se do I duhet ndihma e Këshillit Bashkiak?

Drejtoresha e të Ardhurave Vendore ,Lindita Shuli e merr fjalën;

Në zbatim të Ligjit nr 9936 dt.26.06.2008 “ Për menaxhimine sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”,Vkb nr 108 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025” paraqes për ndryshim të planit buxhetor pasi është e domosdoshme si shtesa të planit në zërin sponsorizime,taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale ,shtesë plani në zërin taksë e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve dhe pakësim të planit në zërin tarifë në sektorin e pyjeve dhe tarife e shfrytëzimit të materialit drusor nga subjektet.Për vitin 2025 të ardhurat janë planifikuar në vlerën 220,385 mije leke.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **17 vota pro.**

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Bujar Vreto,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi,Silvana Hoxha,Veli Terziu,Xhuljeta Boriçi,Arben Hoxha,Habil Biçaku(Këshilltarët e pranishëm).

4. P/Vendim “ Për linjat kryesore dhe oraret e transportit rrethqytetas”

Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën.

Para disa mbledhjeve ne kemi miratuar dhe çmimin e biletës për linjat rrethqytetase ,në ate kohë disa rrugë kanë që të pa afaltuara dhe çmimi ka qënë disi i lartë por tani rrugët janë rregulluar të pothuajse të gjitha dhe çmimi vazhdon i njënjtë. A ka ndonje grup pune që e kontrollon çmimin e biletës në terren?

Drejtoresha e të Ardhurave Vendore ,Lindita Shuli e merr fjalën;

Rrjeti I linjave rrethqytetëse miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet te cënojë rrjetin e linjave qytetësë dhe ndërqytetëse.Për këtë po paraqesim po paraqesim për miratim në Këshillin Bashkiak,linjat dhe oraret e transportit rrethqytetase.Në lidhje me çmimin e biletës ne kemi një grup pune dhe dalin në terren për kontrollin e çmimit të biletës.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (Këshilltarët e pranishëm).

5. P/Vendim “ Për miratimin e ndërhyrjeve në pronë publike për efekt të mbrojtjes së pronave private”.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Po shikoja këto relacionet për të dyja familjet por nuk me pelqen që relacioni të jetë pa bazë ligjore. A ka verifikim në terren nga zyra përkatëse?

Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.

Në fakt probelmi i përroit të shesë është një problem i mbartur, aty duhet duhet një ndërhyrje për gjithë rrjedhën e përroit të shesë, aty janë bërë ndërtime të paligjshme, zabtime nga më te ndryshmet. Meqe jemi në këtë temë. Pse luami del nga shtarti I tij? Ku firmat që po ndërtojnë rrugën marrin dhe hedhin inerte vend e pa vend dhe normalisht ngushtimi lumit do sjelli këto pasoja. Çfarë masash ka marrë bashkia në lidhje me këto firma që kanë prishur shtartin e lumit?

Këshilltarja, Xhuljeta Boriçi e merr fjalën;

Unë jam pro këtij p/vendimi por e kam pyetjen. A ka bashkia ndonjë informacion çfarë familjesh janë dëmtuar? Kërkojmë një informacion dhe në mbledhjene e ardhëshme ti kemi në dispozicion.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Sot në këtë mbledhje ne duhet të kishiim të panishëm Kryetarin e Shtabit të Emergjencave Civile për të na sqaruar mbi situatën e krijuar në vendin tonë.

Sekretari i Përgjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën;

Në rastin e p/vendimit kemi dy familje që kërkojnë të bëjnë investim për të mbrojtur pronën e tyre. Investimet do ti kryejne me shpenzimet e tyre. Në lidhje e Përroit e Shesë ne kemi një projekt shumë të mirë që e kemi dorzuar te Emergjencat Civile dhe te Fondi Shqiptarë i Zhvillimit për të na mundësuar fondin.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (Këshilltarët e pranishëm).

8. Të ndryshme:

1. P/Vendim “ Shtesë fondi për klubin e futbollit Sopoti”.

Sekretari i Përgjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën;

Kjo shtesë fondi që Klubi i Sopotit po kërkon rezulton që në dhjetor stafi dhe futbollistat të ngelnin pa paga. Në qoftë se ne i lëmë pa paga çdo gjë e mire që është krijuar deri tani prishet.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Duhet të ishte i pranishëm dhe Administratori I Klubit për të mbrojtur këtë p/vendim. Po lexoja relacionin dhe shuma totale që ata kërkojnë është 23 milion e pak dhe p/vendimi që ju kërkoni për miratim është në shumën 20 milion leke, po pjesën tjetër ku do ta gjeje,

Shefi i Klubit I Kf Sopotit, Besnik Kola e merr fjalën;

Ne si klub këtë vit kemi hyrë me objektiva të qarta për të nxjerr ekipin e sopotit në një kategori më lart, kemi marrë një staf trajnerësh me eksperience dhe shumë lojtare që kanë qënë pjesë e kategorisë së parë dhe superliges por dhe disa lojtare me ngjyre të vendeve të ndryshme, kjo ka sjelle si pasoj rritjen e buxhetit dhe ne kemi kërkuar ndihmën e Këshillit Bashkiak për miratimin e shtimit të fondit prej 20 milion lekësh të përballojmë dhe muajin dhjetor për pagat e futbollistave dhe stafit të ekipit.

Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.

Jemi pro këtij p/vendimi dhe ishalla këtë sezon në një kategori më lartë.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota pro.

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndrëçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (Këshilltarët e pranishëm).

2. P/Vendim “ Për emërtimin e prishjes së nënobjektit “Palestra e shkollës 9-vjeçare Vilson Blloshmi” Librazhd.

Sekretari i Përgjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën;

Ne kemi fituar projektin për rikostruksionin e shkollës Vilson Blloshmi dhe ndërtimin e palestres së shkolles nga e para, thjeshtë për procedure kemi sjellë pranë jush këtë p/vendim.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota pro.

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Bujar Vreto, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndrëçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Xhuljeta Boriçi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (Këshilltarët e pranishëm).

3. Prezantimi dhe Diskutimi i Raportit të Performancës të Bashkisë Librazhd , viti 2024

Sekretari i Përgjithshëm Bajram Pishkashi e merr fjalën;

Bashkia Librazhd doli e para në rangë performance kjo e matur nga Pushteti Vendor, kemi fituar një grant dhe do ta sjelli tek ju për investim në të mire komunitetit.

Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.

Më vjen mire për performancën e Bashkisë dhe nuk duhet vetëkënaqësi por duhet punë dhe përkushtim ndaj komunitetit. Na është premtuar para nja dy vitesh që salla e keshillit bashkiak do rregullohet por deri tani asgjë, vini dorë që dhe ne te kemi nje sallë komode.

Kërkesë:

Dorheqja e Kryetarit të fshatit Librazhd Katund Z.Urim Mana.

Kryetari i Këshillit Mitat Biçaku e merr fjalën;

Do ngrihet grupi punë nga Këshilli Bashkiak dhe bashkë me Administratorin e Njesisë Qender do merrni pjesë për të bërë zgjedhjet e reja. Do njoftoheni nga Sekretari i Këshillit për ditën që do vendoset.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA



KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BICAKU

